



Prishtinë, 31 mars 2017
Kodi i ZRRE-së: V_904_2017

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 16.1.11 të Ligjit për Energjinë Elektrike,
- Dispozitat e Nenit 10 të Ligjit për Energjinë,
- Dispozitat e Nenit 10 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit,
- Kërkesën e KOSTT SH.A të datës 24.11.2016 dhe 06.03.2017 për shqyrtim dhe aprovimin e dokumentit “Plani Zhvillimor i Transmetimit 2017 – 2026”

në seancën e mbajtur me datë 31.03.2017 nxori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet dokumenti “Plani Zhvillimor i Transmetimit 2017–2026” i KOSTT-it

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 24.11.2016 ka pranuar kërkesën për komentim dhe aprovim të dokumentit “Plani Zhvillimor i Transmetimit 2017 – 2026” të KOSTT SH.A. Në ndërkohë dokumenti ka qenë i publikuar në ueb faqen e KOSTT për diskutim publik. ZRRE ka dhënë komentet e veta të cilat janë përfshirë në dokument, janë sqaruar apo janë marrë përgjigjet në lidhje me çështjet e ngritura.

Pas përfshirjes së komenteve të ZRRE-së, KOSTT me datë 06 mars 2017 ka dërguar dokumentin final për miratim në ZRRE.

ZRRE ka analizuar dokumentin dhe vlerëson se projektet e përfshira në dokument janë të arsyeshme dhe të nevojshme për funksionimin e sigurt të sistemit të transmetimit dhe operimin e tregut dhe se dokumenti përmbush kriteret e kërkuara, kështu që **aprovon “Planin Zhvillimor të Transmetimit 2017 – 2026”**.



- II Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Krenar Bujupi, u.d. kryesuesit

Arsim Janova, anëtar

Besim Sejfi, anëtar